

V E N D I M
Nr. 299, datë 12.5.2001

**PËR REGJISTRIMIN PËR SHITJE TË SIPËRFAQEVE TË TROJEVE TË
OBJEKTEVE NË PRONËSI TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM**
(Ndryshuar me VKM nr. 641, datë 22.11.2001)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sipërfaqet e trojeve, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve të qeverisjes vendore e që u janë dhënë me qira shoqërive huamarrëse në administrim, për të realizuar veprimtaritë prodhuese, të regjistrohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe, sipas autorizimit të lëshuar nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në pronësi të shoqërive huamarrëse në administrim, për shitjen e tyre së bashku me objektin.

2. Shitja e pasurive të shoqërive huamarrëse në administrim, të realizohet pranë Qendrës së Ankandave të shitjes publike me tender, në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore në fuqi.

3. Vlera e truallit e përcaktuar në lidhjen që i bashkëlidhet këtij vendimi, të derdhet, pas shitjes, në buxhetin e bashkisë ose të komunës.

4. Çmimi për m² i sipërfaqes së truallit të jetë 160 lekë për m², siç përcaktohet në pikën 9 të vendimit nr.312, datë 30.6.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për çmimin e truallit që shitet dhe për qiranë e truallit që u jepet në përdorim për ndërtime personave fizikë e juridikë”, ndërsa të ardhurat që do të përfitohen për shlyerjen e kreditorëve nga shitja e pasurive dhe vlera e tyre përcaktohet në treg, në ankandet e shitjes publike, me tender.

5. Administratorët e shoqërive huamarrëse dhe personat e autorizuar nga kryetari i bashkisë apo i komunës, lidhin për vlerën e truallit që do të derdhet në buxhet marrëveshjet përkatëse për kohën e shlyerjes së vlerave financiare, të përcaktuara në lidhjen që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal, Grupi Mbikëqyrës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe administratorët e shoqërive huamarrëse, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Illir Meta

**SIPËRFAQET E TROJEVE TË OBJEKTEVE PËR REGJISTRIM NË PRONËSI TË
SHOQËRIVE HUAMARRËSE DHE VLERA E TRUALLIT PËR PAGESË NË BUXHETIN
E BASHKISË
APO TË KOMUNËS**

Nr.	Objektet	Shoqëria në Administrim	Sipërfaqet e tokës m ²	Çmimi i truallit m ²	Vlera e truallit në lekë
1	Pularia Yzberisht Tiranë	“Vefa Holding”	16 000	160	2 560 000
2	Kompleksi i derrit	“Vefa	44 480	160	7 116 800

	Paskuqan, Tiranë	Holding”			
3	Kombinati i therjes së shpendëve Tiranë	“Vefa Holding”	5 086	160	813 760
4	Kompleksi i shpendeve Paskuqan Tiranë	“Vefa Holding”	36 200	160	5 792 000
5	Kompleksi i gjelit të detit Lushnjë	“Vefa Holding”	16 000	160	2 560 000
6	Pularia Elbasan	“Vefa Holding”	79 800	160	12 768 000
7	Pularia Pukë	“Vefa Holding”	5330	160	852 800
8	Fabrikë vaji Himarë Vlorë	“Vefa Holding”	14 400	160	2 304 00
9	Kompleksi i rritjes së derrit Akerni Vlorë	“Kamberi”	68 800	160	11 008 000
10	Ish merkato nr. 9 Tiranë	“Kamberi”	452	160	72 320
	Totali		257 748	160	41 239 680

SIPËRFAQET E TROJEVE TË OBJEKTEVE PËR REGJISTRIM NË PRONËSI DHE SHOQËRIVE HUAMARRËSE DHE VLERA E TRUALLIT PËR PAGESË NË BUXHETIN E BASHKISË APO TË KOMUNËS
(shtuar me vkm nr. 641, datë 22.11.2001)

Nr.	Objektet	Shoqëria në administrim	Sipërfaqja e tokës në m2	Çmimi i truallit në m2	Vlera e truallit për lekë
11.	Objekti serra, Vlorë	“Kamberi”	30 000	160	4 800 000
12.	Magazinë ambalazhi në ish-ndërmarrjen ushqimore, Vlorë	“Kamberi”	3 250	160	520 000
13.	Ish-ndërmarrja e bonifikimit, Vlorë	“Silva”	12 500	160	2 000 000
14.	Ish-reparti i traktorëve me zinxhirë	“Vefa Holding”	2 995	160	479 200
15.	Ish-reparti i restaurimit të traktorëve N.M. bujqësore	“Vefa Holding”	663	160	106 080